

THIRRJE PËR SHPREHJE INTERESI

Konkurs për Ide Arkitektonike

MASTERPLANI I HYRJES SË PARKUT TË TIRANËS DHE PROJEKT-IDE ARKITEK-
TONIKE PËR 2 GODINA PUBLIKE: QENDRA E SHËRBIMIT PUBLIK (QSHP) DHE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË SË SHTETIT (DPPSH)

Afati Faza I: 14 Prill, 2015

Vendi: Tirana, Albania



TERMAT E REFERENCËS

Promovues

Atelier Albania, me kërkesën e Ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, Ministrisë së Punëve të Brendshme, Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe e mandatuar nga Zyra e Kryeministrit, po shpall nëpërmjet Fondit Shqiptar të Zhvillimit, një konkurs për ide arkitektonike, nëpërmjet të cilit kërkohen idetë më të mira për masterplanin e hyrjes së Parkut të Tiranës, si edhe koncepte inovative arkitektonike për vetë hyrjen e Parkut dhe objektet me karakter publik që propozohet të vendosen në ndërfaqen që lidh qytetin e Tiranës me Parkun.

Manifesto

Hyrja e Parkut të Liqenit për vite me radhë ka qënë temë e disa nismave projektuese. Është kërkuar vazhdimisht mënyra më e mirë për të lidhur qytetin me parkun, nëpërmjet një hapësire të ndërmjetme, por është kërkuar gjithashtu edhe imazhi, apo embema e hyrjes në park.

Pikëpyetjet në lidhje me trajtimin e hyrjes së Parkut të Liqenit gjenerojnë direkt nga pozicionimi i tij në njërin prej skajeve të Bulevardit “Dëshmorët e Kombit” dhe lidhja direkte me Sheshin “Nënë Tereza”. Pavarësisht se Parku i Tiranës ndodhet kaq pranë me këto 2 hapësira kryesore të kryeqytetit lidhja mes tyre mbetet mjaft e dobët.

Nga ana tjetër, vetë Sheshi “Nënë Tereza” ka nevojë për një riprogramim, për arsye se është një hapësirë publike me mjaft potencial, por me përdorim të kufizuar si përgjatë harkut kohor të ditës, ashtu edhe nga pikëpamja e shumëllojshmerisë programatike. Gjithashtu, edhe nga pikëpamja formale, Sheshi “Nënë Tereza” ka nevojë për konturim hapësinor.

Master Plani i Qendrës së Tiranës, ka prezantuar lidhjen e Sheshit “Nënë Tereza” dhe Bulevardit “Dëshmorët e Kombit” nëpërmjet një programi objektsh universitare, të cilat konturojnë hapësirën e sheshit dhe lidhin Parkun me Qytetin nëpërmjet objekteve universitare.

Në vitin 2005, Bashkia e Tiranës hartoi një projekt për Rehabilitimin e Parkut të Tiranës (Liqenit). Në këtë propozim, hyrja e Parkut prezantohej nëpërmjet godinës së Universitetit

Politeknik. Sot ky opsion nuk është më i mundur, pasi UPT ka vendosur ta mbyllë hapësirën e objektit me një volum shtesë. Por ky propozim vendos një vizion se si mund (duhet) të aksesohet Parku i Tiranës, nëpërmjet objekteve apo programeve hapësinore, dhe jo thjesht nëpërmjet një porte ku shënohet “Hyrja”.

Ministria e Arsimit, ka prezantuar nevojën për zgjerimin e mjediseve universitare, po ashtu edhe Universiteti Politeknik i Tiranës ka konfirmuar kërkesën për krijimin e një kampusi universitar, sipas parashikimeve të Master Planit të Qendrës së Tiranës.

Për të gjallëruar jetën në Sheshin “Nënë Tereza” gjatë shtrirjes kohore të ditës, programi universitar duhet rishikuar dhe pasuruar me programe social-kulturore në funksion të rinisë, por jo vetëm.

Paralelisht, në krahun perendimor të hyrjes së Parkut, në territorin e ish-gardës së Republikës, Ministria e Punëve të Brendshme programon ndërtimin e godinës së Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë, e cila njëkohësisht do të ofrojë edhe shërbime të këtij dikasteri.

Po ashtu, edhe Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, është duke programuar ngritjen e një Qendre të Shërbimeve Publike, e cila do të integrojë të gjitha shërbimet që ofron administrata publike për qytetarët në një stacion të vetëm – “Public Servis Mall”. Kjo qendër propozohet të vendoset në territorin e ish-gardës së Republikës.

Për të rakorduar të gjitha këto programe, si edhe për t’i dhënë një zgjidhje hapësinore Hyrjes së Parkut të Tiranës dhe lidhjes së tij me qytetin e konkretisht Sheshin “Nënë Tereza”, si edhe riprogramimit funksional të sheshit me qëllim gjallërimin dhe aktivizimin e tij gjatë gjithë shtrirjes kohore të ditës, është miratuar zonimi funksional i territorit të hyrjes së Parkut të Tiranës. Mbi bazën e këtij zonimi, bëhet edhe shpallja e këtij konkursi për ide arkitektonike.

Përmes kësaj thirrjeje të hapur, Atelier Albania, synon të tërheqë ekipe me arkitektë, pejsazhistë dhe urbanistë. Qëllimi është që të përftohen koncepte sa më origjinale dhe vizionare për ndërhyrje të karakterit arkitektonik dhe urban për Hyrjen e Parkut të Tiranës dhe objekteve publike që do të vendosen në ndërfaqen qytet-natyrë. Për herë të dytë Atelier Albania formulon një konkurs ku kërkohen zgjidhje inovative për zhvillimin e pejsazhit dhe për arritjen e kushtit ‘urban me natyrën’. Është e rëndësishme që konceptet konkurruese të bazohen në parimet që gjenerohen dhe i përgjigjen veçantive të zonës, kërkesave të ushtrimit, por njëkohësisht edhe të informohen nga eksperiencia të sukseshme në vende të tjera.

Përfituesit

Konkursi për Hyrjen e Parkut të Liqenit do t’i japë përgjigje disa problematikave të hapësirës publike të qytetit të Tiranës, si vetë Parkut ashtu edhe Sheshit ‘Nënë Tereza’ apo Sheshit “Frederik Shopen”. Ky konkurs mendohet se do t’i japë gjithashtu përgjigje edhe kërkesave të disa institucioneve publike për hapësira programatike në funksion të interesit publik.

Autoriteti Kontraktues

Fondi Shqiptar i Zhvillimit është autoriteti kontraktor në këtë proces, në emër të Qeverisë Shqiptare.

Objektivi

Produkti i konkursit do të jenë zgjidhjet e projektimit për zhvillimin e pejsazhit të Hyrjes së Parkut të Liqenit dhe disa objekteve me funksion publik në ndërfaqen qytet-natyrë. Konkurentët e përzgjedhur do të zbulojnë zgjidhjet më të mira të projektimit, duke hulumtuar njëkohësisht edhe bashkëjetesën urbane pranë natyrës.

Konkurentëve të përzgjedhur u kërkohet të punojnë për të arritur, si më poshtë::

- Të studiojnë zonën e konkursit dhe rrethinat e tij, programin e tij hapësinor dhe kontekstin social-kulturor;
- Të studiojnë Parkut të Tiranës, sistemin e hapësirave të gjelbra të Bulevardit “Dëshmorët e Kombit” dhe bimësinë e tyre;
- Të studiojnë programet e objekteve publike që propozohen në ndërfaqe, si edhe funksionimin e tyre sot (ekzistueset);
- Të studiojnë jetën social-kulturore të kryeqytetit dhe të evidentojnë nevojat për krijimin e hapësirave të reja social-kulturore në ndërfaqen park-qytet;
- Të hulumtojnë teknologjitë ‘green’ dhe ‘low cost’ dhe të vlerësojnë aplikimin e tyre për ndërtimet publike të programit të konkursit;
- Propozim për master planin e Hyrjes së Parkut brenda kufijve të zonimit funksional të territorit të konkursit;
- Propozim për zhvillimin e pejsazhit të Hyrjes së Parkut të Tiranës;
- Propozim për ide arkitektonike për Hyrjen e Parkut dhe të objekteve publike;
- Propozim për projekt-ide arkitektonike për objektin e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit;
- Propozim për projekt-ide arkitektonike për objektin e Qendrës së Shërbimeve Publike;
- Parashikime të përafërta të kostove të secilit propozim,
- Propozim për një plan veprimi.

Çdo zgjidhje duhet të tentojë kufijtë e krijimtarisë duke u përshtatur ndërkohë me kontekstin lokal dhe duke vendosur standarde të larta të projektimit.

Zona e Konkursit

Zona e konkursit, për të cilën konkurentët do të prezantojnë ide arkitektonike përcaktohet nga harta e zonimit funksional të Hyrjes së Parkut të Tiranës. Zona e studimit, të cilën konkurentët duhet ta njohin dhe informohen mbetet në vlerësimin e tyre profesional.

Qëllimi i Konkursit / Pyetja e Konkursit

Konkursi do të ngrihet mbi tre pyetje:

1. Masterplani i territorit të Hyrjes së Parkut të Liqenit dhe zhvillimi i pejsazhit të ndërfaqes park-qytet,
2. Projekt-ide arkitektonike për objektin publik të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit,
3. Projekt-ide arkitektonike për objektin e Qendrës së Shërbimeve Publike

Detyra e detajuar e projektimit, mbi bazën e të cilës do të jepen përgjigjet për pyetjet e mësipërme nga në fazën e dytë të konkursit, do t'u jepet vetëm konkurentëve të përzgjedhur nga faza e parë. Për të diskutuar mbi detyrën e projektimit dhe kërkesat e saj, do të organizohet në Tiranë një workshop me të gjitha grupet e interesit që përfshin programi i këtij konkursi. Dita e workshopit jepet në kalendarin e konkursit.

Metodologjia

Atelier Albania është një njësi e Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit, e mandatuar për identifikimin e zgjidhjeve alternative dhe pasurimin e arkitekturës e planifikimit nëpërmjet të menduarit përtej kornizave. Në këtë kontekst ne stimulojmë dhe mbështesim pjesëmarrjen e grupeve me profesionistë ndërkombëtarë që do të punojnë së bashku me profesionistë vendas. Ne besojmë se ky bashkëpunim me bazë ekipi do të pasurojë mënyrën sesi informohet projekti me të gjitha njohuritë e nevojshme lokale dhe ekspertizën e nivelit të lartë të projektimit. Për më tepër, ne duam të eksperimentojnë një proces konkursi bashkë – krijues, ku projektuesit dhe disa aktorë lokalë janë të përfshirë në një proces interaktiv përzgjedhës.

Formati i konkursit është eksperimental në mënyrë që të kapërcehen ato që AA beson se janë çështje të pandara të proceseve tipike të konkurseve urbane dhe të arkitekturës.

Rezultatet e pritshme

FAZA 1:

në këtë fazë të short-listimit, kandidatët paraqesin veten e tyre duke ilustruar kapacitetet e tyre, në këtë fazë të short-listimit, kandidatët paraqesin veten e tyre duke ilustruar kapacitetet e tyre, metodologjinë dhe vizionet ndaj subjektit të konkursit. Çdo dorëzim do të shqyrtohet me kujdes nga anëtarët e jurisë dhe ekipet do të përzgjidhen bazuar në kriteret e kualifikimit dhe të vlerësimit të përmendura në Fazën 1.

Mes ekipeve të kualifikuara Juria do të short-listojë ekipet që plotësojnë kriteret e përzgjedhjes së Fazës I. Këto ekipe do të thirren për të punuar gjatë një faze të dytë, për një koncept që do të synojë plotësimin e objektivit të konkursit dhe pyetjeve të konkursit, mbi bazën e një informacioni dhe të një detyre projektimi të detajuar

FAZA 2:

në këtë fazë të Projekt-idesë, secili grup i projekt-aplikimeve do të shqyrtohet me kujdes nga anëtarët e jurisë dhe, bazuar në kriteret të vlerësimit të Fazës 2, do të zgjidhet një ekip fitues.

Bashkimi i skuadrave vendase me të huajat

Çdo ekip ndërkombëtar stimulohet nga organizatorët për t'u lidhur në partneritet me një ekip vendas dhe çdo ekip lokal për t'u lidhur gjithashtu me një partner ndërkombëtar. Atelier Albania beson se një bashkëpunim i tillë mund të rrisë ndikimin e propozimit dhe të përmirësojë zbatimin e projektit. Megjithatë, në thirrjen për fazën e parë, nuk është kusht përzgjedhje që ekipet të kenë një partner lokal apo ndërkombëtar.

Përshtatshmëria

Konkursi është i hapur për të gjithë profesionistët arkitektë, të cilët arrijnë të plotësojnë kërkesat e mëposhtme:

1. të jenë të regjistruar apo të njohur nga një organ zyrtar akreditimi në vendin e origjinës së aplikantit; ose
2. atje ku njohja apo regjistrimi nuk aplikohen me ligj, aplikanti të jetë anëtar i një institucioni profesional, në vendin e origjinës.

Të gjithë aplikantët duhet të japin dëshmi të vlefshmërisë së regjistrimit profesional, njohjes apo anëtarësimit, në Deklaratën e Përbërjes së Skuadrës.

Secili prej ekipeve të Fazës 1 duhet të ketë në përbërje:

1. arkitekt,
2. arkitekt pejsazhi,
3. artist instalator ose artist pamor,
4. inxhinier të strukturave,
5. preventivues,
6. specialist të monumenteve të kulturës.

Të gjithë anëtarët e Ekipit duhet të identifikohen në Deklaratën e Përbërjes së Skuadrës.

Detajimet jepen në shtojcën 6 të Dokumentit Standart të Tenderit. DST mund të përftohen elektronikisht në www.app.gov.al

Dokumente Aplikimi

Konkurentët duhet të dorëzojnë një seri me dokumente, në mënyrë që të jenë në përshtatje me kërkesat e konkurimit për fazën e parë dhe të dytë të konkursit. Dokumentet janë të karakterit ligjor-infomativ. Detajimet në lidhje me dokumentet që duhen dorëzuar jepen në shtojcën 6 të Dokumentit Standart të Tenderit (DST). Ndërkohë më poshtë jepet vetëm një listë e shkurtër e tyre.

Dokumentet e Fazës 1:

- Deklarata e Përbërjes së Skuadrës,
- CV të Stafit Primar,
- Metodologjia,
- Deklarata e Vizionit
- Të gjitha dokumentet e tjera të nevojshme sipas përcaktimeve standarte të Agjencisë së Prokurimit Publik (shtojca 6 e DST)

Dokumentet e Fazës 2:

- Skicë-Ide

Kriteret e Kualifikimit

Juria do t'i zgjedhë aplikantët që do të vlerësohen gjatë fazës së parë bazuar mbi këto kriteret fillestare kualifikimi:

- Qartësia dhe plotësimi i dokumenteve të kërkuara në Fazën 1
- Përbërja profesionale e skuadrës (arkitekti, pejsazhisti, artisti, inxhinieri, specialisti i trashëgimisë)
- Eksperiencat e ngjashme të studios dhe stafit kyç
- Qartësia dhe efikasiteti i metodologjisë së propozuar
- Lidhja e vizionit të prezantuar me zgjidhjen e problematikave të përcaktuara në konkurs

Detajimet jepen në shtojcën 6 të DST

Kriteret e Vlerësimit

Juria do të vlerësojë aplikimet e Fazës 2 bazuar në kriteret e mëposhtme:

- *Krijimtaria*
- *Faktori i lartë i zbatueshmërisë*
- *Lidhje dhe impakti i propozimit me kontekstin*
- *Raporti kosto-impakt (kosto e ulët, impakt i madh)*

Produkti Final

Konkursi do të përfundojë me zgjedhjen e një ekipi. Ekipi fitues duhet të jetë një ekip i mirë-pajisur, i cili do të jetë në gjendje të angazhohet në procesin pas-konkurs.

Skuadra fituese do të angazhohet në fazën tjetër, e cila konsiston në përgatitjen e projekteve të zbatimit për Hyrjen e Parkut të Tiranës dhe 2 objekteve publike. Procesi pas-konkurs do t'i nënshtrohet negociatave me klientin.

Procesi Post-Konkurs

Për të koordinuar më mirë punën mes skuadrës fituese dhe porositësit të projektit, organizatorët parashikojnë 1 takim mes skuadrës, klientit dhe grupeve të interesit, gjatë procesit të detajimit të projekt-idesë. Koncepti këtu është që aktorët të vijnë së bashku për të ndarë idetë, propozimet dhe sugjerimet e tyre, nën kujdesin e anëtarëve të Jurisë dhe institucioneve të specializuara. Ky takim do të realizohet në Tiranë.

Çmimet e Konkursit

Fituesi i konkursit do të vlerësohet me një çmim në vlerë monetare 45,000 Euro.

Do të ketë gjithashtu edhe një çmim të dytë prej 30,000 Euro, si edhe një çmim të tretë në vlerë monetare 20,000 Euro.

Skuadra fituese do të nisë negociatat për projektin e zbatimit.

Platforma e Konkursit

Lloji I Konkursit:	Konkurs Projektimi me Short-Listim
Faza 1:	Thirrje e Hapur për Shprehje Interesi
Kërkesat e Fazës 1:	Sipas Shtojcës 6 të Dokumentit Standart të Tenderit
Avantazh:	Bashkimi i studiove vendase dhe ndërkombëtare të Arkitekturës
Vlerësimi i Jurisë:	Lista e skuadrave të kualifikuara – ‘Lista e Shkurtër’
Faza 2:	Projekt-idea
Kërkesat e Fazës 2:	Dorëzimi i materialeve ilustruese të Projekt-Idesë
Fazë e ndërmjetme:	Vizitë në terren dhe workshop me ‘aktorët’ vendas
Vlerësimi i Jurisë:	Propozimi më i mirë që plotëson kriteret e konkursit
Çmimet:	3 çmime
	Çmimi I: 45,000 Euro
	Çmimi II: 30,000 Euro
	Çmimi III: 20,000 Euro

Kalendari i Konkursit 2015

Thirrje e hapur për shprehje interesi:	20 Mars
Afati Faza 1:	14 Prill, ora 16.00
Lista e Shkurtër:	15-17 Prill
Ftesë për Projekt-Ide:	17 Prill
Përgatitja e Projekt-Idesë:	17 Prill – 14 Qershor
Workshop në Tiranë:	1-2 Maj
Detyra finale e Projektimit + Plani i hapave:	17 Prill
Afati Faza 2:	14 Qershor, ora 18.00
Prezantimet Publike:	15 Qershor
Vlerësimi i Jurisë:	15 Qershor
Shpallja e Fituesve:	15 Qershor

Pas-Konkurs 2015

Negociatat e Kontratës	Qershor – Korrik 2015
Firmosja e Kontratës për Studimin e Fizibilitetit:	Korrik 2015
Procesi i përgatitjes së Studimit të Fizibilitetit:	2015
Takime me AA/Jurinë dhe Grupe Interesi:	Korrik – Tetor 2015
Dorëzimi i Projektit të Zbatimit:	2015

INFORMACIONE PROKURIMI

Faza e shortlistimit do të kryhet nëpërmjet sistemit elektronik në ndërfaqen me adresë: www.app.gov.al.

Dokumentet e tenderit mund të përftohen elektronikisht në po këtë ndërfaqe: www.app.gov.al.

Konkurentët e huaj, në mënyrë që të përdorin sistemin elektronik të prokurimit, duhet të regjistrohen on-line si një operator ekonomik në ndërfaqen: <https://www.app.gov.al/ep/Registration.aspx>.

Instruksione të mëtejshme për konkurentët ndërkombëtarë mund të merren nga manuali i përdoruesit "EPS user manual – Economic Operators", i cili mund të shkarkohet nga ndërfaqja www.app.gov.al.

INFORMACIONE TË MËTEJSHME

Secili prej Termave të Referencës mund të gjenden edhe në faqen zyrtare të Organizatorit të Konkursit:
<http://www.planifikimi.gov.al>

Apo, në faqet e dedikuara për këto Konkurse:
<http://competitions.planifikimi.gov.al/parkentrance/>

Mund të na kontaktoni edhe në:
atelieralbaniacompetitions@planifikimi.gov.al

Sqarimet lidhur me procedurën e prokurimit do të kërkohen vetëm nëpërmjet sistemit elektronik të prokurimit.



AKPT
AGJENCIA KOMBETARE E
PLANIFIKIMIT TE TERRITORIT



Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit
Adresa: Rr. "Muhamet Gjollësja", Nr. 57
Kutia Postare 1023, Tiranë/ Shqipëri

www.turizmi.gov.al
info@turizmi.gov.al

www.planifikimi.gov.al
info@planifikimi.gov.al